



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Data/Datum/Date:	14.12.2022
Nr./Br./No	02/1-178
Për/Za/To:	Kandidatët/Publikun
Nga/Od/From:	Ardita Ndrecaj, Njësia e Burimeve Njerzore
Lënda/Predmet/Subject :	Njoftim për shpalljen e procedurës së konkursit për pranim të jashtëm, Grupi Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale, pozita: Zyrtar për Shërbime Sociale 2

Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë Njësia e Burimeve Njerzore bënë këtë:

NJOFTIM
(për shpalljen e konkursit)

Ju njoftojmë se është bërë shpallja e Konkursit për Pranim të Jashtëm me të dhënat si në vijim:

Grupi: **Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale**

Pozita: **Zyrtar për Shërbime Sociale 2**

Koeficienti: **6.5**

Klasa e pozitës: **Profesional 2**

Vendi i punës: **Qendra për punë sociale-Shtime**

Nr. i kërkuar: **2**

Për informata shtesë referojuni Konkursit të datës 14.12.2022 për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale 2 me numër të Referencës RN00010592 i shpallur në linkun <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në webfaqe të Komunës së Shtimes.

Nëse keni ndonjë paqartësi mund të drejtoheni në Zyren e Personelit në Komunën e Shtimes.

Adresa: Rr. Tahir Sinani, nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA STIMLJE / MUNICIPALITY OF SHTIME



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Shtime shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale
Institucioni	Komuna Shtime
Nr. i Referencës	RN00010592
Kodi	RPC0004262
Data e njoftimit	14.12.2022
Afati për aplikim	04.01.2023 - 12.01.2023

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- i. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara, në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave
- ii. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme duke rekomanduar edhe ndryshime e përmirsimet me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës
- iii. Trajton rastet dhe përgatitë raporte për gjykatën në rastet e heqjes së zotësisë së veprimit për personat e paaftë për të vepruar
- iv. Trajton rastet e fëmijëve pa kujdes prindëror, birësimin e tyre, strehimin familjar, kujdestarinë e përkohshme familjare
- v. Trajton rastet e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikvente, rastet e angazhimit të fëmijëve në punët e rënda dhe lënies së tyre pa kujdes prindëror duke marrë masa dhe veprime të duhura
- vi. Monitoron rastet e dhunës në familje dhe angazhohet në përmirsimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe bën propozimin për besimin e fëmijëve në rastet e shkurorëzimit të prindërve dhe përcjellë realizimin e kontakteve
- vii. Përkujdeset për kategoritë e personave të moshuar, fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, personave që konsumojnë substanca narkotike, alkoolin etj dhe jep propozime për to
- viii. Kryen edhe detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS ose ekuivalente me to në drejtimet: Punë Sociale, Psikologji, Sociologji, Drejtësi, dhe Pedagogji ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare.
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërliken me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0004080	RN00010396	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Profesional 2	6.5	Komuna Shtime	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Komuna e Shtimes	2

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Çertifikatën nga Gjykata që nuk është nën hetime

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- i. Aftësi për të qenë fleksibil dhe për punë në ekip
- ii. Gatishmëri për të shërbyer të gjitha komuniteteve pa dallim
- iii. Njohja e punës me kompjuter në programet (WORD, EXCEL) është e domosdoshme
- iv. Gatishmëria që të punojë punë edhe jashtë orarit të rregullt
- v. Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituara përmes arsimit dhe trajnimeve bazike
- vi. Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin
- vii. Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative teknike në fushën e caktuar
- viii. Aftësi për të punuar me vetë iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen